



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

# **RREGULLORE E PUNËS SË KËSHILLIT DREJTUES TË SHOQATËS SË TË VERBËRVE TË KOSOVËS**



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

## **NENI 1**

### **QËLLIMI I RREGULLORËS**

1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një funksionim sa më efektiv, të drejtë, transparent, të bazuar ligjërisht të veprimtarisë vendimmarrëse të Këshillit Drejtues (KD) pranë Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

## **NENI 2**

### **FUNKSIONI I KËSHILLIT DREJTUES**

2.1 Funksionet e Këshillit Drejtues janë ushtrimi i veprimtarisë vendimmarrëse me qëllim përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara në Statutin e SHVK-së.

## **NENI 3**

### **POZITA NË HIREARKI**

3.1 Sipas statutit të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Këshilli Drejtues është organi i dytë më i lartë i këtij institucioni pas Kuvendit të Përgjithshëm.

## **NENI 4**

### **ZGJEDHJA E KËSHILLIT DREJTUES**

4.1 Këshilli Drejtues zgjidhet nga Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve gjatë Kuvendit Zgjedhor të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

## **NENI 5**

### **KOMPETENCAT E KËSHILLIT DREJTUES**

5.1 Kompetencat e Këshillit Drejtues janë si në vijim:

- Të shqyrtojë dhe miratojë planin vjetor të organizatës.
- Të bëjë shqyrtimin e raporteve periodike të përgatitura nga stafi i shoqatës, gjatë mbledhjeve të rregullta në baza tre mujore.
- Të merr vendime për aspektin operacional apo menaxherial të organizatës në linjë me politikat strategjike të organizatës.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

- Të aprovojë politikat e brendshme operacionale sikurse Rregullorja e Burimeve Njerëzore, Përshkrimi i vendeve të punës, Rregullorja Financiare dhe Prokurimit apo Kodi i mirësjelljes.
- Të jap rekomandime për proceset operacionale të organizatës në varësi të konkluzave të dalura nga shqyrtimi i raporteve të punës.
- Të përzgjedh anëtarët e Komisionit Statutar, Komisionit Organizativ, Komisioni Disiplinor, Grupeve punuese dhe Komisioneve të tjera për çështje specifike.
- Të dërgojë për shqyrtim apo plotësim/ ndryshim politikat e brendshme strategjike sikurse Statutin e Organizatës dhe Planin Strategjik tek Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve.
- Të shpërbëjë apo shkarkojë strukturat menaxheriale të degëve lokale të organizatës dhe të shpallë zgjedhjet lokale për udhëheqësi të re.

## **NENI 6**

### **NUMRI I ANËTARËVE**

6.1 Këshilli Drejtues i SHVK-së përbëhet nga 7 anëtarë me të drejtë vote dhe ata janë:

- Kryetari i Organizatës
- Nënkyetari i parë
- Nënkyetari i dytë
- 4 Anëtarë

6.2 Përfaqësimi gjinor në 6 anëtarët e Këshillit Drejtues të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (duke përfshirë kryetarin/ën), duhet të jetë 50% gra dhe 50% burra.

6.3 Preferohet që përfaqësimi etnik të jetë gjithashtu prezent në Këshillin Drejtues, dhe së paku një anëtar t'i takoj komuniteteve jo-shumicë.

## **NENI 7**

### **MANDATI I ANËTARËVE**

7.1 Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat 5 vjet me mundësi rizgjedhje.

7.2 Mandati i një anëtari mund të pushojë në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit nga detyra.

7.3 Kur mandati i një anëtari pushon, kryetari ka të drejtë të propozojë një anëtar të ri për Këshillin Drejtues.

7.4 Anëtar i ri duhet të legjitimohet në Kuvend, dhe deri atëherë nuk ka të drejtë vote.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

## **NENI 8**

### **PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT NË KËSHILL DREJTUES**

- 8.1 Kryetari i Këshillit Drejtues është përgjegjës kryesor dhe kujdeset për thirrjen, organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të punës së Këshillit Drejtues.
- 8.2 Kryetari e hapë, e kryeson, e ndërprejë dhe e përfundon mbledhjen.
- 8.3 Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit Drejtues kujdeset stafi i shoqatës në bashkëpunim me kryetarin.
- 8.4 Në fillimin e mbledhjes, kryetari e verifikon kuorumin dhe më pas propozon rendin e ditës.
- 8.5 Kryetari hap diskutimin rreth rendit të ditës dhe pas përfundimit të diskutimeve propozimet i hedhë në votim dhe konstaton apo mosmiratimin e rendit të ditës.

## **NENI 9**

### **PËRGJEGJËSITË E ANËTARIT TË KËSHILLIT DREJTUES**

- 9.1 Anëtarët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e punës dhe performancën e përgjithshme të organizatës.
- 9.2 Anëtarët janë përgjegjës për pjesëmarrje në mbledhjet e rregullta të thirrura nga Kryetari i Këshillit Drejtues.
- 9.3 Anëtarët janë përgjegjës për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në kompetencë të Këshillit Drejtues.
- 9.5 Anëtarët propozojë takime të jashtëzakonshme në rast nevojë duke paraqitur kërkesë të arsyetuar tek kryetari, në bashkëpunim me së paku 2 anëtarë të tjerë.
- 9.6 Anëtarët shqyrtojnë dokumentet e prezantuara nga stafi menaxherial i shoqatës. Anëtarët propozojnë nisma inovative dhe avokuese që synojnë të përmirësojnë jetën e qytetarëve të verbër.
- 9.7 Anëtarët përfaqësojnë organizatën në ngjarje relevante kur i kërkohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

## **NENI 10**

### **VENDIMET**

- 10.1 Këshilli Drejtues mund të merr vendimet me shumicë votash.
- 10.2 Në rastet kur nga votimi i të pranishmeve nuk rezulton ndonjë vendim atëherë vota e kryetarit e ka peshën e dy votave.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

10.3 Secili anëtarë ka të drejtë abstenimi në votën e tij/saj për çështje të cilat ai/ajo i vlerëson apo nëse çështjet për të cilat po votohen paraqesin konflikt interesi.

10.4 Anëtarët e Këshillit Drejtues votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.

## **NENI 11**

### **KUORUMI**

11.1 Mbledhja e Këshillit Drejtues është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve ( 4 anëtarë ) , duke përfshirë drejtuesin e mbledhjes (Kryetarin ose zëvendësuesin e autorizuar të tij).

11.2 Në rastet kur nuk plotësohet ky numër në hapjen e mbledhjes, drejtuesi i mbledhjes e shtyn mbledhjen për një kohë tjetër, të paktën 24 ore pas të parës.

## **NENI 12**

### **MBLEDHJET**

12.1 Mbledhjet e KD, zhvillohen sa herë që është e nevojshme por jo më pak se 4 herë gjatë vitit apo çdo 3 muaj, sipas një rendi dite të hartuar para mbledhjes.

12.2 Anëtarët e KD janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhje ( fizikisht apo virtualisht ) , përveç rasteve specifike kur njoftojnë paraprakisht Kryetarin.

12.3 Mbledhja e KD, si rregull zhvillohet gjatë ditëve të punës. Mbledhja mund të zhvillohet edhe ditët e pushimit, përveç ditëve të festave zyrtare.

12.4 Mbledhjet e KD planifikohen dhe thirren rregullisht nga Kryetari për shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve në kompetencë të KD.

12.5 Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje edhe kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën prej 3 (tre) anëtarëve me të drejtë vote të cilët arsyetojnë çështjen për të cilat thirret kjo mbledhje.

12.6 Thirrja për mbledhjen u komunikohet anëtarëve dhe personave pa të drejtë vote që do të marrin pjesë në mbledhje, nëpërmjet njoftimit me shkrim apo njoftimit elektronik. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe duhet të dërgohet së paku 48 orë përpara kohës kur do të zhvillohet mbledhja.

12.7 Këshilli Drejtues në mbledhjet e tij, për çështje të ndryshme mund të ftojë edhe përfaqësues të tjerë të brendshëm apo të jashtëm. Të ftuarit në takimet e Këshillit Drejtues nuk kanë të drejtë vote.

## **NENI 13**

### **ECURIA E MBLEDHJES**



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

13.1 Këshilli Drejtues, pas miratimit të rendit të ditës, duhet të zhvillojë punimet sipas rendit të miratuar.

13.2 Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryetari ose personi i caktuar prej tij, pas të cilit ai e hap diskutimin.

13.3 Kryetari i Këshillit Drejtues i jep fjalën dhe kohën e nevojshme diskutuesit për të diskutuar mbi temën në trajtim për aq kohë sa diskutuesi nuk ka dalë jashtë rendit të ditës, nuk përdorë fjalor jointitucional, fyes apo denigrues si dhe për aq kohë sa nuk përsërit propozimet e thëna njëherë.

13.4 Kryetari e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim, si dhe përkujdeset për racionalizimin e kohës gjatë shqyrtimeve dhe diskutimeve. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryetari.

13.5 Kryetari mund ta ndërpresë mbledhjen përkohësisht, më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit Drejtues kohëzgjatja e ndërprerjes mund të rritet.

## **NENI 14**

### **PROCESVERBALI**

14.1 Lidhur me punën e mbledhjes së Këshillit Drejtues mbahet procesverbali përkatës.

14.2 Procesverbali mbahet nga një anëtar i stafit i autorizuar nga Kryetari për kryerjen e kësaj detyre .

14.3 Procesverbali përmban të dhënat kryesore për mbledhjen ,përkatësisht për rrjedhën e saj dhe nuk kufizohet në informatat si në vijim:

- numrin e seancës,
- datën e mbajtjes,
- vendin e mbajtjes,
- orën e fillimit dhe mbarimit,
- numrin e të pranishmëve dhe emrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues që mungojnë nga mbledhja,
- emrat e personave të tjerë të ftuar që marrin pjesë në punën e mbledhjes;
- propozimet e paraqitura,
- rendin e ditës,
- vendimet dhe konkluzat e miratuara në mbledhjen e Këshillit Drejtues ,
- rezultatet e votimit për pikat e caktuara etj.

14.4 Proces-verbali mbahet në një bllok të lidhur dhe me numër rendor të protokolluar.

14.5 Çdo proces verbal miratohet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues ne ditët pasuese pas mbledhjes, apo më së largu në fillim të mbledhjes së ardhshme të këtij organi.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

## **NENI 15**

### **KOMPENSIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES**

15.1 Kryetari i Këshillit Drejtues meqenëse njëkohësisht bart edhe pozitë të rregullt menaxheriale, nuk gëzon të drejtën e kompensimit për mbledhjet e Këshillit Drejtues.

15.2 Anëtarët e i Këshillit Drejtues për punën e tyre kompensohen financiarisht, përveç në rastet kur edhe ata paguhen në mënyrë të rregullt në kuadër të ndonjë projekti që implementon shoqata.

15.3 Kompensimi i tyre për mbledhjen e mbajtur është 20 Euro.

15.4 Kompensimi aplikohet për secilën mbledhje të rregullt çdo 3 muaj.

15.5 Kompensimi lejohet për më së shumti një mbledhje të jashtëzakonshme brenda çdo tre mujori.

15.6 Shpenzimet e transportit mbulohen për anëtarin e Këshillit Drejtues dhe shoqëruesin e tij/saj, mbi bazën e transportit publik për relacionin ardhje vajtje.

15.7 Shpenzimet e transportit anëtarin e Këshillit Drejtues dhe shoqëruesin e tij/saj, duhet të kompensohen për secilën mbledhje të mbajtur.

## **HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj me Vendim të Kuvendit të Anëtarëve.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
Kosova Association of the Blind  
Udruzenje Slepih Kosova

## KONFIRMIM

Për Leximin e Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës

Ju lutem lexoni deklaratat e mëposhtme, dhe konfirmoni leximin/ pranimin e tyre në kolonën e tretë përmes shenjës “x” në mënyrë individuale për secilën deklaratë

	Deklaratat	Konfirmo me x
1	Konfirmoi që kam pranuar një kopje elektronike apo fizike të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues në SHVK	
2	Konfirmoi që e kam lexuar Rregulloren e Punës së Këshillit Drejtues në SHVK, dhe se e kam kuptuar atë në tërësi.	
3	Konfirmoi që unë do të ju bindem këtyre politikave, rregullave dhe procedurave.	
4	Konfirmoi që e kam kuptuar se kjo Rregullore duhet të përdoret vetëm për nevojat e mia dhe nuk duhet të shpërndahet me palë të tjera.	
5	Konfirmoi që e kam kuptuar që kjo Rregullore mund të modifikohet, plotësohet, apo shfuqizohet nga Kuvendi i Përgjithshëm i Anëtarëve	

Emri dhe Mbiemri i Anëtarit të Këshillit Drejtues: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i Anëtarit të Këshillit Drejtues: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_